

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Konfirmohen 7 raste me virusin e Nilit Perëndimor në Kosovë, regjistrohen dy viktima
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/konfirmohen-7-raste-me-virusin-e-nilit-perendimor-ne-kosove-regjistro-i515010
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 13:48:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 13:36:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c3bf2300fa0e82303bc5487f188da441a0ca3f6bb61185ca4f4d2dec3e355b12
TEKSTI	94221cf097ad16855cf65f376e038d9c16cbcb48424b6ed5319501c47737eb80
PAMJA	b0c13db68deac5770ccbbe9f3a907971b85b4b4f1aa7461fdc4619a3dd3991a7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	642c0e7a781990981192d6ea4bb90a10338e813966a052d776e5c12423b5ef66
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a624a8de2af3663fb45f82c1ddada674f965fa5760c0cdbc3d58cf8121d973c9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/642c0e7a781990981192d6ea4bb90a10338e813966a052d776e5c12423b5ef66>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

57 MINUTA ME PARE

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

3 ORE ME PARE

Krim në familje/ I moshuari godet me thikë gruan, humb jetën në spital. Shoqërohet dhëndëri i tyre në Polici

20 ORE ME PARE

111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

1 DITE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

Aktualitet

Konfirmohen 7 raste me virusin e Nilit Perëndimor në Kosovë, regjistrohen dy viktima

IKSHPK tha se të gjitha personat e prekur janë shtruar në Klinikën Infektive të QKUK-së në Prishtinë: Tre me shenja klinike të meningjtit akut, tre me shenja të meningoencefalitit akut dhe një rast me gjendje febrile.



19 Shtator 2026, 15:36
Nga E. D



Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

KOSOVË- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës ka njoftuar se dy persona kanë humbur jetën nga virusi i Nilit Perëndimor në Kosovë, ndërsa shtatë raste janë konfirmuar me këtë virus gjatë periudhës 7 gusht–18 shtator 2026.

"Prej tyre, pesë janë meshkuj dhe dy femra. Dy raste i përkasin grupmoshës 10–19 vjeç, ndërsa rastet e tjera janë të moshave deri në 79 vjeç. Tri raste janë nga Gjakova, ndërsa nga një rast është regjistruar në Prishtinë, Shtime, Ferizaj dhe Pejë", thuhet në njoftimin e IKSHPK.

IKSHPK tha se të gjitha personat e prekur janë shtruar në Klinikën Infektive të QKUK-së në Prishtinë: Tre me shenja klinike të meningjtit akut, tre me shenja të meningoencefalitit akut dhe një rast me gjendje febrile.

"Gjatë kësaj jave janë raportuar dy raste të vdekjes nga ËNV në Kosovë. Nga analiza fillestare nuk është evidentuar lidhje epidemiologjike ndërmjet rasteve, prandaj ato janë klasifikuar si sporadike. Vetëm një nga shtatë rastet ka raportuar histori udhëtimi jashtë vendit", thuhet më tej në njoftim.

IKSHPK ka informuar edhe për situatën epidemiologjike në rajon.

"Që nga fillimi i sezonit të transmetimit për vitin 2026 dhe deri më 10 shtator, sipas ECDC-së, janë identifikuar 1,285 raste humane të virusit të Nilit Perëndimor në 15 shtete evropiane, përfshirë edhe disa vende fqinje të Kosovës", tha IKSHPK.

Masat e ndërmarra

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:14

EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 12:06

Krim në familje/ Burri godet me thikë gruan, humb jetën në spital për shkak të plagëve

Të gjitha Qendrat Rajonale të Shëndetit Publik kanë komunikuar me komunat në rajonet e tyre për ngritjen e vigjilencës dhe ndërmarrjen e masave konkrete për parandalimin e përhapjes së virusit. Një ekip i IKSHPK-së, në bashkëpunim me QRSHP Gjakovë, është angazhuar në terren në Gjakovë, ku janë raportuar tri raste, për vlerësimin dhe hulumtimin e situatës epidemiologjike.

Vizitë e ngjashme është realizuar edhe nga QRSHP Ferizaj, ndërsa QRSHP-të kanë planifikuar takime me komunat gjatë javës së ardhshme. Në laboratorët e IKSHPK-së po analizohen edhe mostra të tjera të dyshimta, ndërsa vazhdojnë aktivitetet për monitorimin dhe kontrollin e situatës epidemiologjike.

IKSHPK-ja u bën thirrje të gjitha komunave, në veçanti atyre ku janë konfirmuar raste, që të intensifikojnë dezinfektimin kundër mushkonjave dhe eliminimin e vatrave të shumimit të tyre. Masat duhet të përfshijnë spërkatjen në zonat me prani të shtuar të mushkonjave, largimin e mbeturinave dhe sanimin e kanalizimeve të hapura.

Për mbrojtje personale rekomandohet përdorimi i repelentëve kundër mushkonjave, veshja e rrobave me ngjyra të çelëta që mbulojnë pjesën më të madhe të trupit, vendosja e rrjetave mbrojtëse në dritare dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse në ambient të jashtëm.

Udhëtarët që vizitojnë zona ku raportohen infeksione të transmetuara nga mushkonjat, pas kthimit, rekomandohet të përcillet gjendja shëndetësore për paraqitjen e temperaturës, dhimbjes së kokës, lodhjes, skuqjes së lëkurës ose shenjave neurologjike. Në rast të shfaqjes së simptomave duhet të kërkohet vlerësim mjekësor pa vonesë dhe profesionisti shëndetësor të informohet për historinë e udhëtimit dhe ekspozimin e mundshëm ndaj mushkonjave./Dosja.al

instituti kombëtar i shëndetësisë publike të kosovës

Sondazh

Poll

Aktualitet
19 Shtator 2026, 15:10

Shqipëria i bashkohet NASA-s për eksplorimin e Hënës dhe Marsit/ Më 21 shtator nënshkruan marrëveshjet ‘Artemis’! Bëhet vendi i 73-të pjesëmarrës në eksplorimin e hapësirës

NASA TIRANË- Shqipëria do të nënshkruajë Marrëveshjet Artemis gjatë një ceremonie që do të zhvillohet t&e...

Vrau gruan me thikë brenda në banesë, del fotoja e 68-vjeçarit

Aktualitet

AKTUALITET 19 SHTATOR 2026, 11:56

Çfarë ndodhi në Tiranë? Qëllohet me armë zjarri në ajër, plagoset lehtë një person

më të klikuarat

Pagat e magistratëve/ Shefja e Thesarit Tiranë: Krevat pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Emri i një pensionisti u përdor për ndryshimin e 45 identiteteve. Pezullohen 2 zyrtarë, Indrit Aliu shpallet në kërkim

Gazetarja publikoi dy artikuj ku denoncoi vjedhjen e tenderave, Ilirjan Celibashi kërcënon me mesazhe Desada Metajn: Mos u merr më me këtë çështje

“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit

insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e “shkarkoi” sot Edi Ramen?

Moti

Powered by  tomorrow.

Aksident në Fier-Patos, motoristi i picave mbetet i plagosur

Aktualitet

19 Shtator 2026, 13:39

Vrau gruan me thikë, dorëzohet në polici Hysni Patushi

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:59

Krimi brenda familjes, policia jep detajet: Autori në kërkim

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:22

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:14

EMRAT+DETAJE/ Burri vrau gruan në banesë, zbulohen identitetet, në shtëpi dhe nipi 14-vjeçar

Policia TIRANË- Detaje të reja kanë dalë në lidhje me krimin në familje në Tiranë. Mësohet se Hysni Patus...

Krim në familje/ Burri godet me thikë gruan, humb jetën në spital për shkak të plagëve

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:06

Vendesi Gëzim Tanullia në Museum e

VENDOSI ÇELIÇIA TËPUNIMI NË MUZEUM E
Gjirokastrës si manekin/ Jep dorëheqjen
drejtori i Agjencisë së Trashëgimisë
Kulturore: Përgjegjësia është e imja

Aktualitet

19 Shtator 2026, 12:03

Çfarë ndodhi në Tiranë? Qëllohet me
armë zjarri në ajër, plagoset lehtë një
person

Aktualitet


19 Shtator 2026, 11:56

Trafik heroine dhe kokaine në Francë/
Goditet sërish rrjeti kriminal i
shqiptarëve, dy në pranga nga grupi
'Ronaldo' (EMRAT)

Aktualitet

19 Shtator 2026, 11:19

MË SHUMË



I moshuari godet me thikë gruan, humb jetën në spital.
Shoqërohet dhëndëri i tyre në Polici



Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP TIGA Mediodesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.